

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-179/13

**Prishtinë,
16 korrik 2014**

Në çështjen juridike të

SH.H

Pala ankuese /Pala përgjegjëse në kërkesë

Kundër

D.R.D

Paraqitësi i kërkesës/ Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Elka Filcheva -Ermenkova dhe Dag Brathole, Gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/187/2013 (lëndët e regjistruara si KPA51690, KPA51691, KPA51692, KPA51693, KPA51694, KPA51696, KPA51697), të datës 13 shkurt 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 16 korrik 2014, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- **Bashkohen lëndët GSK-KPA-A-181/13, GSK-KPA-A-183/13, GSK-KPA-A-179/2013, GSK-KPA-A-184/13, GSK-KPA-A-180/13, GSK-KPA-A-182/13 dhe**

GSK-KPA-A-185/13 në një lëndë të vetme të regjistruar me numrin GSK-KPA-A-179/13.

- 2- **Refuzohet ankesa e SH.H kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/187/2013 (lëndët e regjistruara si KPA51690, KPA51691, KPA51692, KPA51693, KPA51694, KPA51696, KPA51697), e datës 13 shkurt 2013.**
- 3- **Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/187/2013 (lëndët e regjistruara si KPA51690, KPA51691, KPA51692, KPA51693, KPA51694, KPA51696, KPA51697), i datës 13 shkurt 2013.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 14 nëntor 2007, D.R.D ka paraqitur kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore dhe ri-posedimin e 2/3 të ngastrave të përshkruara si 40/32; 40/30; 40/30; 40/14/4; 40/30/2;40/30/2; 40/30/1 që të gjitha ndodhen në tokat e fshatit Bajcina, Podujevë. Sipas planit aktual kadastral këto ngastra tani në total janë 2 me numrat 1600 dhe 1601 {e vërtetuar *ex officio* nga Sekretaria Ekzekutive (SE) e KKPK-së}.
2. D.R.D e ka paraqitur kërkesën si anëtar i familjes së bartësit të së drejtës pronësore, që është babai i tij R.D.D. Ky i fundit ka trashëguar 2/3 e pronave të kërkuara.
3. Prona ishte humbur për shkak të konfliktit të armatosur në Kosovë në periudhën 1998/1999. Data e specifikuar e humbjes ishte 16 qershor 1999. Paraqitësi i kërkesës ka prezantuar një vendim të trashëgimisë, të lëshuar nga Gjykata Komunale e Podujevës më 3 prill 1961. Në vendim thuhej se R.D dhe motra e tij O.D janë trashëgimtarë të të ndjerit D.D me hiset prej 2/3 për R.D dhe 1/3 për O.D. Sipas vendimit, ngastrat e kontestuar përbëjnë pjesë të trashëgimisë të D.D. Vendimi është verifikuar pozitivisht nga SE e KKPK-së. Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së gjithashtu ka vërtetuar se në kadastrin aktual pronat janë ende në emër të D.D.
4. Pronat janë njoftuar fizikisht në vitin 2012. Pala përgjegjëse në kërkesë SH.H i ka kontestuar kërkesat, duke pohuar se babai i tij i kishte blerë këto ngastra në vitin 1985 nga personi i tretë B.B.

5. KKPK-ja i ka pranuar kërkesat si të bazuara dhe ka lëshuar vendimin e ankimuar, *pra* KPCC/D/A/187/2013 (lëndët e regjistruara në si KPA51690, KPA51691, KPA51692, KPA51693, KPA51694, KPA51696, KPA51697), të datës 13 shkurt 2013
6. KKPK-ja ka pranuar se bartësi i së drejtës pronësore R.D.D është pronar i 2/3 të pronave. KKPK-ja e ka konsideruar kërkesën të provuar mirë në bazë të vendimit të trashëgimisë dhe të dhënave në fletën poseduese. KKPK-ja nuk i ka shqyrtuar pohimet e palës përgjegjëse në kërkesë si të deshmuara, për shkak se pala përgjegjëse në kërkesë kishte paraqitur vetëm deklaratat me shkrim nga gjoja shitësi i tokës B.B dhe djali i tij. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 26 qershor 2013.
7. Më 19 korrik 2013, vendimi i është dorëzuar SH.H. Më 6 gusht 2013, ai ka paraqitur një ankesë kundër vendimit.
8. Pala ankuese pretendon se vendimi është i padrejtë pasi që mohon të drejtën e tij pronësore mbi pronën pas 28 viteve. Ai pohon se ata (familja e tij) e kishin blerë tokën në vitin 1985; ata nuk e kanë uzurpuar tokën.
9. Ai pretendon se të drejtat e tij dëshmojnë me deklaratat e shumë dëshmitarëve dhe se të gjithë fshatarët e dinë se familja e tij e ja shfrytëzuar këtë tokë që nga viti 1985.

Arsyetim ligjor

Bashkimi i lëndëve:

10. Gjykata i referohet nenit 408.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej LPK), që zbatohet *mutatis mutandis* në procedurën para Gjykatës Supreme (neni 12.2 i Ligjit 03/L-079). Ky nen i jep mundësinë Gjykatës që t'i bashkojë procedurat nëse një bashkim i tillë kontribuon në efikasitetin e këtyre procedurave.
11. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme konstaton se e gjithë baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave janë plotësisht të njëjta në të 7 (shtatë) lëndët. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë, edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e KKPK-së për kërkesat është i njëjtë.
12. Lëndët e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-181/13, GSK-KPA-A-183/13, GSK-KPA-A-179/2013, GSK-KPA-A-184/13, GSK-KPA-A-180/13, GSK-KPA-A-182/13 dhe GSK-KPA-A-185/13 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar me numrin GSK-KPA-A-179/13.

Pranueshmëria e ankesës:

13. Ankesa është e pranueshme; ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve të paraparë me nenin 12.1 të Ligjit 03/L-079 që ka ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale; në tekstin e mëtejme Ligji 03/079.

Meritat e ankesës:

14. Ankesa është e pabazuar.
15. Është vërtetuar se R.D (babai i paraqitësit të kërkesës) dhe motra e tij O.D i kanë trashëguar pronat e kontestuara nga babai i tyre i ndjerë D.D në vitin 1961. 2/3 ishte pjesa e R.D dhe 1/3 ishte pjesa e O.D. Nuk ka të dhëna se në vitin 1985 apo në çfarëdo kohe tjetër ndërmjet viteve 1961 dhe 1999 R.D ia ka transferuar 2/3 të pjesëve të tij ideale të pronës SH.H apo ndonjë personi tjetër.
16. Deklaratat me shkrim të paraqitura nga SH.H nuk paraqesin prova për vërtetimin e të drejtës pronësore mbi pronat e kërkuara. Sipas nenit 4, paragrafi 2 i Ligjit për Qarkullimin e Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr: 43/81), kontratat për bartjen e të drejtave në pronë të paluajtshme ndërmjet bartësve të drejtave pronësore duhet të lidhen në formë shkresore dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese duhet të vërtetohen nga gjykatat. Në mungesë të një kontrate të tillë, pretendimet për bartjen e të drejtës pronësore janë të pabazuara.
17. Në qoftë se në vitin 1985 ka ekzistuar ndonjë marrëveshje joformale në mes pronarëve të vërtetë R.D dhe O.D në njërin anë dhe familjes së palës ankuese në anën tjetër për shfrytëzimin e pronës, edhe kjo nuk do të rezultonte në bartjen e të drejtës pronësore, e cila, siç u cek, duhet të bëhet në formë të shkruar dhe me vërtetim të nënshkrimeve. Megjithatë, në rastin konkret, nuk ka ndonjë shënim se një marrëveshje e tillë ka ekzistuar ndonjëherë. Pala përgjegjëse në kërkesë thjeshtë po pretendon se e ka blerë pronën nga një palë e tretë, pa pasur ndonjë kontratë të shitblerjes për këtë dhe pa pasur ndonjë dëshmi se vet kjo palë e tretë ka pasur të drejta mbi këtë pronë. Përveç kësaj, nuk ka prova se posedimi faktik i R.D mbi pronat ishte ndërprerë ndonjëherë para konfliktit të armatosur në vitet 1998 dhe 1999.
18. Pasi që nuk ka prova për bartjen e të drejtës pronësore ndërmjet viteve 1961 dhe deri në vitin 1999 në dobi të palës ankuese, nuk ka arsye që Gjykata ta anulojë apo ndryshojë vendimin e KKPK-së e cila e ka pranuar kërkesën si të bazuar.

19. Prandaj, në përputhje me nenin 13.3 të Ligjit, Gjykata e ka refuzuar ankesën dhe e ka vërtetuar vendimin.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Dag Brathole, Gjyqtra i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it